

STRUKTURA E TREGUESVE EKONOMIKË NË SEKTORIN PRIVAT JO FINANCIAR

VITET 2010-2016

VALMIRA BEBRI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
vbebri@instat.gov.al

ETUGERT LLAZI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
ellazi@instat.gov.al

Abstrakt

Studime të ndryshme citojnë që performanca ekonomike e një vendi ndikohet nga struktura ekonomike e tij. Për t'iu ardhur në ndihmë studiuesve dhe politikëbërësve, ky material do fokusohet në studimin e strukturës ekonomike për sektorin privat jo financiar në Shqipëri. Rezultatet tregojnë se struktura e treguesve ekonomikë është përgjithësisht e qëndrueshme pavarësisht ndryshimit vjetor të secilit prej treguesve. Analiza e strukturës është mbështetur në rezultatet e vërtetimit strukturor vjetor pranë ndërmarrjeve të realizuar nga INSTAT.

FJALË KYÇE:

Struktura e ekonomisë; Sektori privat jo financiar; Punësimi; Vlera e shtuar; Investimet; Statistika gjinore

1. HYRJE

Qëndrueshmëria ekonomike e një vendi vërehet tek stabiliteti i strukturës ekonomike të tij. Për të kuptuar strukturën ekonomike analizohet sjellja e sektorëve që përbëjnë ekonominë. Studimi në këtë artikull përfshin të gjitha ndërmarrjet aktive, për të gjitha format ligjore, që prodhojnë të mira e shërbime për treg, me përjashtim të aktiviteteve të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, administrimi publik dhe mbrojtjes, siguri social i detyrueshëm, si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare.

Në këtë studim janë analizuar të dhënat e vrojtimit strukturor vjetor pranë ndërmarrjeve për vitet 2010-2016. Ky vrojtim mbledh të dhëna statistikore për tregues bazë dhe makroekonomikë, në rreth 16 mijë ndërmarrje. Treguesit bazë përfshijnë të dhëna mbi aktivitetet ekonomike, numrin e ndërmarrjeve dhe të punësuarve, si edhe të ardhurat, shpenzimet dhe investimet të shprehura në çmime korrente. Treguesit makroekonomikë janë prodhimi, konsumi ndërmjetës dhe vlera e shtuar, të cilat derivojnë nga treguesit bazë.


2. NJË EKONOMI PRODHUESE APO E ORIENTUAR DREJT SHËRBIMEVE?

Treguesi më i rëndësishëm makroekonomik është vlera e shtuar. Për periudhën e marrë në studim (2010-2016), për çdo 100 lekë vlerë të shtuar që ndërmarrjet krijojnë në ekonomi, mesatarisht 48 lekë është lënë nga prodhuesit e të mirave dhe 52 lekë nga prodhuesit e shërbimeve.

Të dhënat e analizuar tregojnë, si në Figurën 1, se në tre vitet e fundit ka një rritje të vazhdueshme të këtij treguesi, duke kapur vlerën 491 miliardë lekë në 2016, ku prodhuesit e shërbimeve kanë lënë 272 miliardë lekë vlerë të shtuar në ekonomi, ndërsa prodhuesit e të mirave 219 miliardë lekë. Ndryshe paraqitet situata në vitin 2013, ku rezulton se ky është i vetmi vit ku prodhuesit e shërbimeve kanë kontribuar negativisht në vlerën e shtuar. Ndikim në rënien prej 3,3% të vlerës së shtuar, e kanë dhënë ndërmarrjet prodhuese të shërbimeve të cilat kontribuan me -6,8 pikë përqindje, përkundërt kontributit të prodhuesve të të mirave me +3,4 pikë përqindje.

Vlera e shtuar ka pësuar rënien më të lartë në vitin 2011, ku ndikim në rënien 6,4% të vlerës së shtuar e kanë pasur ndërmarrjet prodhuese të të mirave, të cilat kontribuan me -8,5 pikë përqindje, të ndikuara nga performanca e keqe e sektorit të energjisë elektrike dhe rënia e bumit të ndërtimeve, përkundërt kontributit pozitiv të prodhuesve të shërbimeve me +2,1 pikë përqindje.

Figura 1: Vlera e shtuar (miliardë lekë) sipas prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve gjatë viteve 2010-2016



Për të kuptuar luhatjet e vlerës së shtuar në vite, shohim edhe sjelljen e dy treguesve të tjerë si vlera e prodhimit dhe konsumi ndërmjetës. Prodhimi është një aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale (ndërmarrje) që kombinon burimet e fuqisë punëtore, kapitalin dhe lëndën e parë, për të prodhuar të mira dhe kryer shërbime.

Gjatë viteve të studiuara, vlera e prodhimit ka pasur një rritje të vazhdueshme, duke arritur në 1.164 miliardë lekë në vitin 2016, siç paraqitet në Figurën 2. Për periudhën 2010-2016, ky tregues është rritur mesatarisht me 6,7%, i ndikuar nga prodhuesit e shërbimeve që në vetvete u rritën mesatarisht me 9,2% dhe prodhuesit e të mirave që u rritën mesatarisht me 5%.

Për prodhuesit e shërbimeve, tendenca e vetme negative vërehet për vitin 2013, me rreth -1,1% duke kontribuar me -0,5 pikë përqindje në rritjen gjithsej prej 0,9% të prodhimit për vitin 2013.

Konsumi ndërmjetës përfaqëson vlerën e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit, duke përjashtuar përdorimin e aktiveve fikse.

Konsumi ndërmjetës ka pasur rritje të vazhdueshme, siç paraqitet në Figurën 3, ku ritmi i rritjes së këtij treguesi tejkaloi atë të vlerës së prodhimit, duke sjellë rënie të vlerës së shtuar.

Një rënie e konsumit ndërmjetës vihet re për prodhuesit e të mirave për vitet 2013 me -0,3% dhe 2014 me 2,3%, duke kontribuar negativisht në ndryshimin vjetor gjithsej të këtij treguesi; respektivisht me -0,2 pikë përqindje për 2013 dhe -1,4 pikë përqindje për 2014.

Figura 2: Vlera e prodhimit (miliardë lekë) sipas prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve gjatë viteve 2010-2016





Figura 3: Konsumi ndërmjetës (miliardë lekë) sipas prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve gjatë viteve 2010-2016



3. MË E LEHTË TË SHËRBESH...

Të dhënat e studimit tregojnë se ndërmarrjet që operojnë në ekonominë tonë janë të orientuara drejt shërbimeve. Struktura e numrit të ndërmarrjeve në vite shpreh se sektorët, të cilët janë zgjeruar më shumë, janë sektori i shërbimeve të tjera (20,0% në 2016 nga 12,5% që zinte në 2010) dhe sektori i akomodimit dhe shërbimit ushqimor (18,5% në 2016 nga 16,5% që zinte në 2010). Ndërsa, sektorët e tkurrur në përqindje janë tregtia (41,5% në 2016 nga 44,7% që zinte në 2010), transporti dhe komunikacioni (7,2% në 2016 nga 10,9% që zinte në 2010), industria përpunuese (8,6% në 2016 nga 10,4% që zinte në 2010) dhe


ndërtimi (3,1% në 2016 nga 4,1% që zinte në 2010), siç paraqiten në Tabelën 1.

Nga ecuria e numrit të ndërmarrjeve, shohim që gjatë vitit 2015 kemi përqindjen më të lartë të rritjes së këtij treguesi me 22,7% e ndikuar edhe nga nisma e qeverisë kundër informalitetit. Prodhuesit e shërbimeve, gjatë gjithë viteve të marra në studim, kanë pasur rritje të vazhdueshme të numrit të ndërmarrjeve. Për ndërmarrjet e prodhimit të të mirave, numri i tyre ka pasur rënie për vitet 2012 me -7,2% dhe 2014 me -6,6%, duke kontribuar përkatësisht me -1,2 pikë përqindje dhe -1,0 pikë përqindje në ndryshimet vjetore të këtij treguesi.

Tabela1: Struktura në numër dhe përqindje e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike, 2010-2016

Aktivitete ekonomike	2010		2011		2012		2013		2014		2015		2016	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Gjithsej	76,954	100	79,969	100	83,591	100	84,790	100	85,206	100	104,534	100	108,526	100
Prodhuesit e të mirave	11,839	15.4	13,055	16.3	12,116	14.5	12,480	14.7	11,660	13.7	13,269	12.7	13,875	12.8
Industri nxjerrëse	409	0.5	461	0.6	513	0.6	528	0.6	619	0.7	626	0.6	498	0.5
Industri përpunuese	8,013	10.4	8,328	10.4	7,731	9.2	7,912	9.3	7,015	8.2	8,137	7.8	9,337	8.6
En. elek., gazi, uji dhe trajtimi i mbetjeve	294	0.4	441	0.6	409	0.5	542	0.6	531	0.6	679	0.6	656	0.6
Ndërtim	3,123	4.1	3,825	4.8	3,462	4.1	3,497	4.1	3,495	4.1	3,827	3.7	3,384	3.1
Prodhuesit e Shërbimeve	65,114	84.6	66,913	83.7	71,475	85.5	72,310	85.3	73,546	86.3	91,265	87.3	94,650	87.2
Tregti	34,385	44.7	34,724	43.4	36,918	44.2	36,674	43.3	36,357	42.7	45,093	43.1	45,041	41.5
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	12,687	16.5	12,773	16.0	13,678	16.4	13,784	16.3	14,637	17.2	18,586	17.8	20,043	18.5
Transp., inform., komunikacioni	8,389	10.9	8,671	10.8	8,255	9.9	8,492	10.0	8,176	9.6	7,365	7.0	7,838	7.2
Shërbime të tjera	9,654	12.5	10,745	13.4	12,625	15.1	13,360	15.8	14,377	16.9	20,221	19.3	21,729	20.0

Figura 4: Numri i ndërmarrjeve sipas prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve gjatë viteve 2010-2016



4. CILI SEKTOR PUNËSON MË SHUMË?

Gjatë vitit 2010, një ndërmarrje prodhuese të mirash punësonte mesatarisht 10 persona, ndërsa prodhuesit e shërbimeve 2 persona. Ky tregues, për vitin 2016, është 12 persona mesatarisht të punësuar në prodhuesit e të mirave dhe 3 persona të punësuar në prodhuesit e shërbimeve. Për të gjitha vitet e marra në studim, të dhënat tregojnë se numrin më të lartë të të punësuarve për ndërmarrje e ka sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve, ndërsa numrin më të ulët e ka sektori i tregtisë dhe akomodimit dhe shërbimit ushqimor.

Ecuria e numrit të të punësuarve, siç shihet në Figurën 5, paraqitet me rritje të vazhdueshme në

vite për prodhuesit e të mirave dhe shërbimeve, pavarësisht uljes së numrit të ndërmarrjeve në prodhuesit e të mira, gjatë viteve 2012 dhe 2014. Ashtu si për numrin e ndërmarrjeve, edhe numri i të punësuarve rritjen më e lartë e ka pasur në vitin 2015 (+17,4%), me kontribut përkatësisht për prodhuesit e të mirave me +4,2 pikë përqindje dhe shërbimeve me +13,2 pikë përqindje.

5. FEMRA, FUQI PUNËTORE E BRISHTË

Edhe pse të dhënat e marra në studim tregojnë se ka një rritje të angazhimit të femrave të punësuar, pothuajse në të gjitha aktivitetet ekonomike përsëri mbetet në nivele të ulëta, përkundrejt punësimit të meshkujve. Në vitin 2010 vetëm 29,9% e të punësuarve ishin femra, ndërkohë që në vitin 2016

Figura 5: Numri i të punësuarve sipas prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve gjatë viteve 2010-2016




Tabela 2: Përqindja e të punësuarave femra në vite sipas aktiviteteve ekonomike

Aktivitete ekonomike/Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjithsej	29.9%	30.6%	29.5%	28.4%	37.3%	35.8%	37.3%
Prodhuesit e të mirave	32.6%	32.5%	31.8%	29.5%	39.0%	37.0%	39.7%
Industri nxjerrëse	9.6%	8.8%	9.0%	6.8%	10.9%	10.7%	11.9%
Industri përpunuese	48.6%	51.4%	49.0%	45.4%	58.8%	55.0%	59.0%
En. elek., gazi, uji dhe trajtimi i mbetjeve	31.5%	20.3%	24.2%	17.6%	25.7%	24.5%	18.4%
Ndërtim	9.9%	10.0%	9.9%	10.8%	14.3%	12.7%	12.2%
Prodhuesit e Shërbimeve	27.9%	29.1%	28.1%	27.8%	36.3%	35.2%	36.0%
Tregti	29.6%	29.6%	27.4%	31.1%	36.8%	35.3%	36.8%
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	31.8%	34.2%	31.8%	28.6%	36.5%	30.5%	33.4%
Transp., inform., komunikacioni	16.0%	18.8%	15.9%	15.8%	25.6%	27.7%	26.6%
Shërbime të tjera	32.1%	32.4%	33.9%	28.5%	40.0%	39.7%	39.7%

pjesëmarrja e femrave është 37,3% siç shihet në tabelën 2. Pjesëmarrja më e lartë e femrave vihet re në sektorin e industrisë përpunuese (sidomos gjatë tre viteve të fundit të studimit, në sajë edhe të politikave mbështetëse për sektorin fason), ndërsa përqindja më e ulët është në sektorin e industrisë nxjerrëse.

6. KU PO INVESTOHET?

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet, me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se një vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën. Vlera e investimeve paraqitet me rritje gjatë viteve të fundit, e influencuar edhe nga projektet madhore në infrastrukturë dhe energji.

Nëse analizojmë prodhuesit e të mirave, investimet e realizuara prej tyre paraqiten me rënie në vitin 2012 me -6%, duke kontribuar negativisht në investimet gjithsej me -3,9 pikë përqindje. Për

prodhuesit e shërbimeve, rënie në investime ka pasur gjatë viteve 2014 dhe 2016, duke kontribuar negativisht në ndryshimin vjetor të këtij treguesi, respektivisht me -9,4 pikë përqindje dhe -8,1 pikë përqindje.

Nga analiza e strukturës së investimeve në vite, sipas llojeve të investimeve, shohim që ndërmarrjet kryesisht investojnë në instalime, makineri, pajisje dhe ndërtesa, dhe më pak në tokë. Në vitin 2016, një ndërmarrje investon afërsisht 2 milionë lekë nga 1,1 milionë lekë të investuara mesatarisht për një ndërmarrje në vitin 2010.

Si konkluzion i këtij studimi mund të themi që struktura e ekonomisë shqiptare nuk ka pësuar ndryshime thelbësore ndër vitet e marra në studim. Nga analiza e secilit prej treguesve vihet re një rritje e lehtë të peshës së prodhuesve të shërbimeve në ekonomi, përkundërt prodhuesve të të mirave.

Figura 6: Investimet (miliardë lekë) sipas prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve gjatë viteve 2010-2016

